



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

4-POLIS
NR. 67/16, PROT.
DT. 24.05.2016

Nr. 5240 Prot.

Tiranë, më 20.05.2016

URDHËR

Nr. 269, datë 20/05/2016

**“PËR
AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË,
“MASTER PROFESIONAL” NË “ADMINISTRIM BIZNESI” ME PROFILE
“SIPËRMARRJE DHE INOVACION”, “PASURITË E PALUAJTSHME”,
“MARKETING DHE STRATEGJI”, NDËRMJET UNIVERSITETIT “POLIS” DHE
IPAG BUSINESS SCHOOL, PARIS, FRANCË”**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Administrim Biznesi”, me profile “Sipërmarrje dhe Inovacion”, “Pasuritë e Paluajtshme” dhe “Marketing dhe Strategji”, të Fakultetit “Planifikim, Mjedis dhe Menaxhimi Urban” të Universitetit “Polis”, ndërmjet Universitetit “Polis” dhe “IPAG Business School”, Paris, Francë, që realizohet me 90 kredite, me formë studimi me kohë të zgjatur, me kohëzgjatje 2 vite akademike/4 semestra, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “Administrim Biznesi”, me profile “Sipërmarrje dhe Inovacion”, “Pasuritë e Paluajtshme” dhe “Marketing dhe Strategji”.
2. Ky program studimi akreditohet në bazë të Vendimit nr. 123, datë 18.02.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti “Polis”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

VENDIM

Nr. 123, datë 18.02.2016

PËR

AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER PROFESIONAL NË "ADMINISTRIM BIZNESI" ME PROFILE: SIPËRMARRJE DHE INOVACION; PASURITË E PALUAJTSHME; MARKETING DHE STRATEGJI", MIDIS UNIVERSITETIT "POLIS" DHE IPAG BUSINESS SCHOOL, PARIS, FRANCË

Këshilli i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë" i ndryshuar dhe mbështetur në procedurën e ndjekur nga APAAL, raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe dokumentacionin mbështetës, për programin e studimit, me elementët si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në "Administrim Biznesi" me profile: Sipërmarrje dhe inovacion; Pasuritë e paluajtshme; Marketing dhe strategji.
- b) Cikli i studimit: Cikli i Dytë
- c) Vendimi i hapjes/licencimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 336, datë 16.08.2013*
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti "Polis" dhe IPAG Business School, Paris, Francë

* Në kërkesën drejtuar MAS për ndryshimin e Urdhërit të Licencimit kërkohet që ky program të ofrohet sipas parashikimeve të Nenit 80, pika 4, të Ligjit 80-2015, si program i përbashkët studimi. Licenca e MAS me Nr. 336, datë 16.08.2013 përcakton si ofrues të vetëm Universitetin POLIS. Ky program studimi nuk është aktivizuar si i tillë dhe institucioni nuk ka regjistruar studentë në vitin akademik 2013-2014. Aktivizuar në vitin 2014-2015 si program i përbashkët me IPAG Business School, Paris, Francë dhe me kohë të zgjatuar.

- e) Fakulteti përgjegjës i Universitetit "Polis": Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 Vite/ 4 Semestra
- g) Kredite (ECTS): 90 Kredite
- h) Forma e studimi: Me kohë të zgjatur
- i) Statusi i diplomës: Diplomë e përbashkët me IPAG Business School, Paris, Francë
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të kualifikimeve: Niveli 7

VENDOSI

1. Programi i përbashkët i studimit, Master Profesional në *"Administrim Biznesi" me profile: Sipërmarrje dhe inovacion; Pasuritë e paluajtshme; Marketing dhe strategji"* i ofruar midis Universitetit "Polis" dhe IPAG Business School, Paris, Francë, i përmbush plotësisht "Standardet shtetërore të cilësisë" për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë.
2. Mbështetur në gjithë sa më sipër, Këshilli i Akreditimit vendos të japë për këtë program studimi vlerësim **pozitiv**.
3. Këshilli i Akreditimit i rekomandon Ministrin të Arsimit dhe Sportit që, programi i studimit, Master Profesional në *"Administrim Biznesi" me profile: Sipërmarrje dhe inovacion; Pasuritë e paluajtshme; Marketing dhe strategji"* me elementët e mësipërm, **të akreditohet**.
4. Universiteti "Polis", për programin e studimit, Master Profesional në *"Administrim Biznesi" me profile: Sipërmarrje dhe inovacion; Pasuritë e paluajtshme; Marketing dhe strategji"*, duhet të sigurojë që standardet, mbi bazën e të cilave është dhënë akreditimi, të përmbushen për të gjithë periudhën kohore të vlefshmërisë së akreditimit. Ngarkohet Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë të monitorojë në vazhdimësi ruajtjen e këtyre standardeve dhe të raportojë pranë Këshillit të Akreditimit.

KËSHILLI I AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

ARJAN GJONÇA


Kryetar



* Në kërkesën drejtuar MAS për ndryshimin e Urdhërit të Licencimit kërkohet që ky program të ofrohet sipas parashikimeve të Nenit 80, pika 4, të Ligjit 80-2015, si program i përbashkët studimi. Licenca e MAS me Nr. 336, datë 16.08.2013 përcakton si ofrues të vetëm Universitetin POLIS. Ky program studimi nuk është aktivizuar si i tillë dhe institucioni nuk ka regjistruar studentë në vitin akademik 2013-2014. Aktivizuar në vitin 2014-2015 si program i përbashkët me IPAG Business School, Paris, Francë dhe me kohë të zgjatur.

ALEKSANDËR XHUVANI

Anëtar



ANILA PAPANISTO

Anëtar

IRING WASSER

Anëtar

ALEXANDER KOHLER

Anëtar



SULO HADËRI

Anëtar




ODETA BARBULLUSHI

Anëtar


MYFTAR BARBULLUSHI

Anëtar




ILIR PANDA

Anëtar




FATMIR GURI

Anëtar



LINDA ZENELAJ

Anëtar



Shënim: Znj. Anila Papanisto, Z. Iring Wasser dhe Znj. Odetta Barbullushi nuk ishin të pranishëm në këtë mbledhje.

* Në kërkesën drejtuar MAS për ndryshimin e Urdhërit të Licencimit kërkohet që ky program të ofrohet sipas parashikimeve të Nenit 80, pika 4, të Ligjit 80-2015, si program i përbashkët studimi. Licenca e MAS me Nr. 336, datë 16.08.2013 përcakton si ofrues të vetëm Universitetin POLIS. Ky program studimi nuk është aktivizuar si i tillë dhe institucioni nuk ka regjistruar studentë në vitin akademik 2013-2014. Aktivizuar në vitin 2014-2015 si program i përbashkët me IPAG Business School, Paris, Francë dhe me kohë të zgjatur.